



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080

federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

# KODI ETIK I FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 03.10.2022

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## PËRMBAJTJA:

<b>KREU I. PËRKUFIZIMET .....</b>	<b>4</b>
<b><i>NENI 1</i> .....</b>	<b>4</b>
<b>KREU II. QËLLIMI DHE ZBATIMI I KODIT ETIK .....</b>	<b>8</b>
<b><i>NENI 2 - QËLLIMI</i> .....</b>	<b>8</b>
<b><i>NENI 3 - ZBATIMI</i> .....</b>	<b>9</b>
<b>KREU III. PARIMET E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>10</b>
<b><i>NENI 4 - SJELLJA ETIKE, LOJALITETI, INTEGRITETI DHE SJELLJA SPORTIVE ..</i></b>	<b>10</b>
<b><i>NENI 5 - PARIMET THEMELORE .....</i></b>	<b>10</b>
<b><i>NENI 6 - PRANIMI I DHURATAVE APO PAGESAVE.....</i></b>	<b>11</b>
<b><i>NENI 7 - DOKUMENTE APO INFORMATA TË RREJSHME.....</i></b>	<b>11</b>
<b>KREU IV. ORGANIZIMI I NJË GARE ZYRTARE TË BASKETBOLLIT ....</b>	<b>12</b>
<b><i>NENI 8 - ORGANIZIMI I GARËS .....</i></b>	<b>12</b>
<b><i>NENI 9 - PËRDORIMI I DUHUR I MUZIKËS DHE MIKROFONAVE .....</i></b>	<b>13</b>
<b><i>NENI 10 - PARIME TË TJERA .....</i></b>	<b>13</b>
<b>KREU V. LOJA E NDRERSHME (FAIR PLAY) .....</b>	<b>15</b>
<b><i>NENI 11 - 'RREGULLAT E ARTA' .....</i></b>	<b>15</b>
<b>KREU VI. KUJDESI .....</b>	<b>17</b>
<b><i>NENI 12 - MIRËQENIA E LOJATRËVE.....</i></b>	<b>17</b>
<b><i>NENI 13 - DETYRIMET PËR KUJDES NDAJ TË TJERËVE.....</i></b>	<b>18</b>
<b>KREU VII. KONFIDENCIALITETI .....</b>	<b>20</b>
<b><i>NENI 14.....</i></b>	<b>20</b>
<b>KREU VIII. ADMINISTRIMI I MIRË .....</b>	<b>21</b>
<b><i>NENI 15.....</i></b>	<b>21</b>

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

## KREU IX. KONFLIKTI I INTERESIT .....23

**NENI 16 - QËLLIMI I DISPOZITAVE PËR KONFLIKT INTERESI..... 23**

**NENI 17 - OBLIGIMI NDAJ FBK-SË..... 23**

**NENI 18 - DEKLARIMI I ÇDO KONFLIKT INTERESI ..... 25**

## KREU X. BAST-VËNIA DHE MANIPULIMI I GARAVE .....25

**NENI 19 - BAST-VËNIA APO MANIPULIMI ..... 25**

## KREU XI. KOMISIONI I ETIKËS .....27

**NENI 20 - VEPRIMTARIA, ANËTARËT DHE PROCEDURAT..... 27**

## KREU XII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE .....28

**NENI 21 - JURIDIKSIONI..... 28**

**NENI 22 - PROGRAMET EDUKATIVE ..... 28**

**NENI 23 - INTERPRETIMI I KODIT ETIK ..... 29**

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Mbështetur në Nenin 21 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, dhe i harmonizuar plotësisht me Kodin Etik dhe të Integritetit të Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit (FIBA), Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës, më 03.10.2022, miraton këtë:

## KOD ETIK

### KREU I. PËRKUFIZIMET

#### NENI 1

1. Termet dhe shprehjet e përdorura në këtë Kod kanë këtë kuptim:

##### 1.1. Palë të basketbollit - nënkupton:

- a) Çdo shoqatë, klub ose organizatë tjetër (përfshirë ligat) që në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë janë anëtarë ose pjesë e FBK-së;
- b) Personat e punësuar nga, ose të angazhuar në aktivitete në emër të FBK-së (pavarësisht a paguhen apo jo), të licencuar nga, ose që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me FBK-në ose me ndonjërin nga entitetet nën alinenë a) më lart;
- c) Zyrtarët e basketbollit;
- d) Pjesëmarrësit;
- e) Spektatorët (shih alinenë 1.12);
- f) Çdo person, qytet ose dhe të ngjashëm që aplikojnë për të drejtën për të organizuar ngjarje/gara të FBK-së, përfshirë edhe Komitetin Organizativ Lokal të formuar për të organizuar ngjarjet e tilla; dhe
- g) Çdo person tjetër që i nënshtrohet Statutit dhe akteve normative të FBK-së.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## 1.2. KOK – Komiteti Olimpik i Kosovës.

**1.3. Garë basketbolli** – Çdo garë zyrtare basketbolli ose garë në nivel kombëtar të pranuar nga një FBK-ja.

**1.4. Zyrtar i basketbollit** – Çdo zyrtar i FBK-së, FIBA-s, një nga divizioneve të FIBA-së, Federatës Kombëtare (anëtare e FIBA-së), Komitetit Organizativ Lokal, ose KOK-ut, që ndër të tjera përfshin:

- a) cilindo kandidat ose të nominuar për tu zgjedhur ose caktuar në pozitë në FBK, FIBA, Divizion të FIBA-s ose në Federatat Kombëtare anëtare të FIBA-s;
- b) sa i përket FBK-së, anëtarët e Bordit të FBK-së, Komitetit Ekzekutiv, Sekretariati, sa i përket FIBA-s, anëtarët e Bordit Qendror të FIBA-s, Komitetit Ekzekutiv, Bordeve Zonale, Sekretariatit;
- c) anëtarët e Zyrës Ekzekutive të FBK-së;
- d) anëtarët e komisioneve, komiteteve, grupeve punuese ose forcave në detyrë (task force) ose organeve të ngjashme të caktuara nga FIBA, Divizioni i FIBA-s apo Federata Kombëtare anëtare e FIBA-s, të caktuar për çfarëdo qëllimi;
- e) të punësuarit e FIBA-s ose Divizionit të FIBA-s në nivel të drejtorit ose kryesuesit;
- f) anëtarët e Panelit të Etikës të FIBA-s;
- g) anëtarët e organeve gjyqësore të FIBA-s;
- h) zyrtari i FIBA-s për Integritet;
- i) zyrtari i FBK-së për Integritet (SPOC Personi);
- j) anëtarët e Komisionit të Etikës të FBK-së.

**1.5. Përfitim** – Para ose diçka e barasvlershme me para (duke përfshirë arsyet legjitime, siç janë paratë nga shpërblimet dhe/ose

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





pagesat kontraktuale që bëhen në përputhje me kontratat për mbështetje, sponsorizim ose të tjera).

**1.6. Basti** - Bast në para ose në çfarëdo forme tjetër të spekulimit financiar të bërë në një garë basketbolli që ka të bëjë me rezultatin e ndeshjes; ose çfarëdo aspekti të ndonjë ngjarjeje apo procesi, që ndër të tjera përfshin edhe gjatat që të ndodhë ose të mos ndodhë diçka; ose nëse diçka është e vërtetë apo jo.

**1.7. Kurdisje apo Bast-vënie** - Vënia, pranimi ose vendosja e një basti (qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet një pale/entiteti të tretë) që ndër të tjera, përfshin aktivitete të njohura zakonisht si baste sportive, siç janë koeficientet fiks dhe të rrjedhshëm, lojërat të njohura si totalizator/toto, bastet e drejtpërdrejta, shkëmbimi i basteve, përhapja e basteve dhe lojëra të tjera të ofruara nga operatorët e basteve sportive.

**1.8. Konflikti i interesit** - Çfarëdo situatë në të cilën vendimmarrja e personit në fjalë që ka të bëjë me FBK-në ndikohet (p.sh. një konflikt i vërtetë) ose mund të perceptohet nga një person i arsyeshëm që ka gjasa të ndikohet (p.sh. konflikt i perceptuar) nga interesat personale, familjare, financiare, afariste ose interesat e tjera private. Konflikti i interesit gjithashtu përfshin edhe konflikt të mundshëm të interesit, si p.sh. një situatë, e cila sipas vlerësimit të arsyeshëm të një personi, mund të kalojë në një konflikt të vërtetë ose të perceptuar të interesit.

**1.9. Personi që ka lidhje me (Person i afërm me zyrtarin)** - Çdo individ me të cilin Personi në fjalë ka marrëdhënie që sipas gjykimit të një personi tjetër mund të duket që mund të ndikojë në objektivitetin e personit në fjalë, e këtui ndër të tjera përfshihet familja e ngushtë, partneri i tij/saj dhe miqtë e ngushtë.

**1.10. Divizion i FIBA-s** - Të gjitha divizionet e FIBA-s, që ndër të tjera përfshijnë të gjitha zonat, organet e zonave, zyrat rajonale, nën-zonat, nën-nën-zonat, komisionet, etj.

**1.11. Pjesëmarrësit** - Çdo person që ka rol të drejtpërdrejtë ose tërthortë në basketboll, që ndër të tjera përfshijnë:

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- a) lojtarët dhe agjentët ose përfaqësuesit e tyre;
- b) personelin mbështetës të lojtarit (p.sh. trajnerët, ndihmës-trajnerët, mjekët, fizio-terapeutët, etj.);
- c) çdo person tjetër të përfshirë në listën zyrtare të delegacionit të ekipit të Federatës Kombëtare, anëtare e FIBA-s;
- d) komisionarët;
- e) zyrtarët e ndeshjes (p.sh. gjyqtarët, delegatët teknikë, komisionarët, zyrtarët e tavolinës, etj.);
- f) përcjellësit me përgjegjësi të veçanta (p.sh. menaxherët, zyrtarët për mbajtjen e statistikave, përkthyesit, maskotat, etj.);
- g) personat e punësuar nga, ose të angazhuar në aktivitete në emër të (pavarësisht a paguhen apo jo) ose që kanë lidhje të drejtpërdrejta ose të tërthorta me FBK-në, FIBA-n, një divizion të FIBA-s ose Komitetin Organizativ lokal; dhe
- h) çdo person tjetër, i akredituar ose që merr pjesë në një ndeshje zyrtare.

**1.12. Spektatorët** – Personat që kanë përdorur ose kanë një biletë, akreditim, ftesë, ose që në ndonjë mënyrë tjetër marrin pjesë në një ndeshje zyrtare, që përfshijnë:

- a) shikuesit (të gjithë personat që e përcjellin ngjarjen sportive nga tribunat përkatëse; dhe
- b) tifozët (grupe të organizuara të shikuesve të regjistruara si OJQ, të cilat përkrahin ekipet e tyre sportive)

**1.13. Informatat e brendshme** – Çfarëdo informate në lidhje me pjesëmarrjen ose performancën e mundshme të një ekipi ose garuesi që merr pjesë në një garë basketbolli, të cilën një individ e posedon për shkak të pozitës së tij/saj në sport. Një informatë e tillë ndër të tjera përfshin informatat faktike në lidhje me garuesit, kushtet, çështjet taktike ose çfarëdo aspekti tjetër të garës së basketbollit, por

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





nuk përfshin informatat që tashmë janë publikuar ose që janë pjesë e të dhënave publike, që lehtësisht mund të sigurohen nga një pjesëtar i interesuar i publikut ose të bëhen të ditura në pajtueshmëri me rregullat dhe rregulloret që rregullojnë garën përkatëse të basketbollit.

**1.14. Interesi jomonetar** - Interesi personal që një individ mund të ketë në një çështje që mund të përfshijë marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet me miqtë e ngushtë ose interesat e tjerë privat që nuk përfshijnë mundësinë për fitim ose humbje financiare.

**1.15. Zyrtar** - Çdo person që është në detyrë, është i zgjedhur ose i caktuar në një pozitë ose çdo person i caktuar në cilësinë e zyrtarit ose që me fjalë të tjera përfaqëson një entitet (ligjor ose tjetër).

**1.16. Ndeshja zyrtare** - Çdo ndeshje e garës së basketbollit.

**1.17. Interesi monetar** - Interesi që një individ mund ta ketë në një çështje për shkak të mundësisë së arsyeshme ose pritjes për fitim ose humbje financiare për individin në fjalë ose ndonjë person tjetër me të cilin ai/ajo ka lidhje.

**1.18. Person** - Çdo person fizik ose një organizatë apo entitet tjetër, si organet e korporatave, shoqatat ose ortakëritë e painkorporuara (pa marrë parasysh nëse ndonjëra prej tyre ka personalitet të ndarë juridik).

**1.19. Grupet e ndjeshme** - Të miturit, ose çdo individ i ndjeshëm ose që mund të jetë i rrezikuar nga abuzimi ose shpërfillja për shkak të aftësive të kufizuara të tyre mendore ose fizike, moshës, sëmundjes ose nevojës për kujdes apo përkrahje.

## KREU II. QËLLIMI DHE ZBATIMI I KODIT ETIK

### NENI 2 - QËLLIMI

**1.** FIBA mban përgjegjësinë për të ruajtur integritetin dhe reputacionin e basketbollit në mbarë botën. Misioni i FIBA-s është që basketbolli në botë

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:







të paraqitet si lojë energjike, e shëndetshme dhe atletike, e pa dhunshme dhe larg praktikave jo-etike të çfarëdo lloji.

**2.** Prandaj, në përputhje me parimet e FIBA-s, ky Kod i Etikës i detyron palët e basketbollit të sigurojnë që basketbolli të administrohet dhe luhet në përputhje me sjelljen etike, të ndershme e të drejtë, transparente, demokratike, të besueshme, të denjë dhe profesionale, dhe në frymë të lojës së ndershme dhe integritetit. Të gjitha palët e basketbollit janë përgjegjëse për veprimet e tyre dhe duhet të respektojnë paprekshmërinë dhe obligimet e besnikërisë ndaj FBK-së dhe FIBA-s.

**3.** Palët e basketbollit dhe përfaqësuesit e tyre nuk do të përfshihen me kompani ose persona, veprimtaria ose reputacioni i të cilëve është në kundërshtim me parimet e tjera të cekura në këtë Kod.

**4.** Palët e basketbollit respektojnë të drejtën e të gjithë individëve për trajtim të denjë dhe me respekt.

### NENI 3 - ZBATIMI

**1.** Ky Kod i Etikës zbatohet për të gjitha Palët e basketbollit (të definuara në nenin 1.1 të këtij Kodi).

**2.** Palët e basketbollit i nënshtrohen pushtetit disiplinor të FBK-së (ose edhe FIBA-s), duke përfshirë edhe sanksionet e parapara.

**3.** Palët e basketbollit i nënshtrohen, i pranojnë dhe duhet të jenë të familjarizuar me Statutet e Përgjithshme, Rregulloret e Brendshme, dhe politikat apo vendimet tjera të FBK-së dhe FIBA-s.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## KREU III. PARIMET E PËRGJITHSHME

### NENI 4 - SJELLJA ETIKE, LOJALITETI, INTEGRITETI DHE SJELLJA SPORTIVE

1. Palët e basketbollit do t'iu përmbahen parimeve të sjelljes etike, lojalitetit, integritetit dhe sjelljes sportive. Ato nuk do të ndërmarrin asnjë veprim që ka ndikim të dëmshëm për basketbollin dhe për namnin e tij ose të ndonjë politike të FBK-së dhe FIBA-s.
2. Palët e basketbollit nuk duhet të diskriminojnë në bazë të racës, gjinisë, origjinës etnike, fesë, mendimit filozofik ose politik, statusit civil, ose në çfarëdo baze tjetër.

### NENI 5 - PARIMET THEMELORE

1. Palët e basketbollit pajtohen të:

**1.1.** Qëndrojnë besnik ndaj FBK-së dhe parimeve të saj, si dhe ndaj basketbollit, dhe nuk do veprojnë në mënyrë që diskrediton ose dëmton reputacionin e FBK-së dhe të basketbollit;

**1.2.** Përvetësojnë ndershmërinë, integritetin dhe respektin si vlera themelore të të gjitha aktiviteteve të basketbollit dhe të mos iu japin të tjerëve me vetëdije informacione të rrejshme;

**1.3.** Mos përfshihen në ndonjë vepër penale ose vepër tjetër në kundërshtim me ligjin, e as në aktivitete të pahijshme, brenda ose jashtë basketbollit;

**1.4.** Evitojnë aktivitetet që mund të ndikojnë në rezultatet përfundimtare të garave të basketbollit, duke përfshirë edhe:

- a) Pranimin e përfitimeve; dhe
- b) Ofrimin e përfitimeve.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- 1.5.** Garantojnë mirëqenien mendore, fizike, sigurinë e lojtarëve, si dhe garantojnë kujdes mjekësor të përshtatshëm për basketboll;
- 1.6.** Përpiqen të mbrojnë mjedisin në çdo rast kur organizojnë gara të basketbollit;
- 1.7.** Respektojnë të gjitha kontratat që kanë të bëjnë me basketbollin dhe nuk i nxisin të tjerët që t'i shkelin ato kontrata;
- 1.8.** Përmbahen nga zbulimi i informatave të besueshme që i dinë në mirëbesim; dhe
- 1.9.** Respektojnë transaksionet komerciale të kryera në mirëbesim dhe të drejtat e pronës intelektuale.

## NENI 6 - PRANIMI I DHURATAVE APO PAGESAVE

- 1.** Anëtarët dhe stafi i palës së basketbollit duhet t'i deklarojnë dhuratat ose gjësendet e pranuar në emër të mikpritjes nga nikoqirët; këto dhurata nuk duhet t'i tejkalojnë standardet mbizotëruese në Republikën e Kosovës (me referencë në Kapitullin V të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave ).
- 2.** Palët e basketbollit ose përfaqësuesit e tyre nuk duhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kërkojnë, pranojnë ose ofrojnë çfarëdo forme të pagesës ose komisionit, e as ndonjë përfitim apo shërbim të fshehtë të çfarëdo natyre që lidhet me aplikimin për organizimin e ndonjë gare të basketbollit.

## NENI 7 - DOKUMENTE APO INFORMATA TË RREJSHME

- 1.** Palët e basketbollit, për kurrfarë arsye, nuk do të dorëzojnë dokumente të rrejshme, të falsifikuara ose informata tjera të pavërteta në FIBA, FBK, KOK, ose në ndonjë tjetër Federatë Kombëtare (anëtare të FIBA-së).

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## KREU IV. ORGANIZIMI I NJË GARE ZYRTARE TË BASKETBOLLIT

### NENI 8 - ORGANIZIMI I GARËS

**1.** Palët e basketbollit i respektojnë plotësisht doracakët e ndryshëm të publikuar nga FIBA lidhur me përzgjedhjen e organizatës nikoqire (sido që të përkufizohet), në veçanti Doracakun për aplikim dhe organizim.

**2.** Ato palë të basketbollit që dëshirojnë të organizojnë një Garë Zyrtare basketbolli në asnjë hap të procesit të aplikimit nuk do t'i afrohen ndonjë pale tjetër të basketbollit ose ndonjë pale të tretë me qëllim të përfitimit të mbështetjes financiare ose politike, që bien ndesh me dispozitat e këtyre manualëve dhe/ose këtë Kod të Etikës.

**3.** Çdo ndeshje zyrtare organizohet në përputhje me të gjitha rregulloret, udhëzimet, doracakët, direktivat dhe vendimet e aplikueshme të FIBA-s, dhe në përputhshmëri me Ligjin Nr. 05/L-075 për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive. Në veçanti, ndër të tjera, palët e basketbollit:

**3.1.** Do t'ju përmbahen kërkesave për sallë në rregulloret e aplikueshme;

**3.2.** Do të sigurojnë të gjitha pajisjet (dhe/ose pajisjet zëvendësuese) thelbësore për organizimin e ndeshjes zyrtare;

**3.3.** Do t'ju përmbahen kërkesave për pajisje (dhe/ose pajisje zëvendësuese) të shënuara në Rregullat zyrtare të basketbollit ose kërkesat tjera të përkufizuara nga FIBA;

**3.4.** Do të zbatojnë masat e duhura të sigurisë brenda dhe jashtë objektit;

**3.5.** Do të sigurojnë që në asnjë rrethanë të mos vihet në rrezik ose të kërcënohet siguria e palëve të basketbollit ose palëve të treta, duke përfshirë këtu edhe shikuesit ose palët e tjera të treta brenda ose përreth objektit gjatë ose menjëherë para/pas ndeshjes zyrtare; dhe

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**3.6.** Do të respektojnë detyrimet e nikoqirit sipas rregulloreve të aplikueshme.

**3.7.** Të respektojnë kërkesat për reklamim sipas rregulloreve të aplikueshme.

## NENI 9 - PËRDORIMI I DUHUR I MUZIKËS DHE MIKROFONAVE

**1.** Sa i përket përdorimit të duhur të muzikës dhe mikrofonave gjatë ndeshjes zyrtare, të referohen rregullat e aplikueshme. Në veçanti, ndër të tjera, palët e basketbollit do të sigurojnë se:

**1.1.** Instrumentet muzikore nuk luhen nga një grup muzikor live gjatë një ndeshjeje zyrtare në ndonjë vend të sallës përveç në hapësirën dhe kohën e lejuar nga FIBA;

**1.2.** Muzika nuk luhet përmes sistemit të njoftimit publik (as e incizuar më herët ose nga një grup muzikor live) dhe mikrofoni përdoret në mënyrë neutrale.

**1.3.** Mikrofoni përdoret në mënyrë neutrale (p.sh. mikrofoni nuk mund të përdoret për të inkurajuar një skuadër të caktuar e as për të nxitur tifozët e një skuadre të caktuar).

## NENI 10 - PARIME TË TJERA

**1.** Në veçanti, ndër të tjera, palët e basketbollit:

**1.1.** Nuk do të përdorin lojtar(ë) të paregjistruar ose që nuk i plotësojnë kushtet; ose të përfshijnë më shumë se një lojtar që ka fituar shtetësinë ligjore të atij vendi përmes natyralizimit ose ndonjë mënyre tjetër pasi të kenë mbushur gjashtëmbëdhjetë (16) vjet; ose

**1.2.** Do të kenë në listë të paktën dhjetë (10) lojtarë që i përmbushin kushtet në fillim të një ndeshjeje zyrtare.

**2.** Palët e basketbollit nuk do të përfshihen në sjellje josportive. Në veçanti, ndër të tjera, palët e basketbollit:

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**2.1.** Nuk do të përfshihen në çfarëdo sjellje që dëmton imazhin ose reputacionin e FBK-së, FIBA-s dhe/ose të basketbollit, ndër të tjera, duke përfshirë kërcënimin, kanosjen, fyerjen dhe/ose abuzimin verbal ose fizik ndaj palës tjetër të basketbollit dhe/ose palës tjetër të tretë;

**2.2.** Nuk do të përdorin gjeste, fjalë, gjësende ose mjete tjera për të përçarur porosi të papërshtatshme për një ngjarje sportive, veçanërisht porosi të natyrës politike, ideologjike, fetare, raciste, fyese ose provokuese;

**2.3.** Nuk do të abuzojnë ose dëmtojnë pajisjet në sallë ose në objektet tjera që shfrytëzohen për gara (pajisjet në parket, zhveshtoret, hotel, etj.); ose

**2.4.** Nuk do të shprehen në mënyrë përçmuese ndaj palës tjetër të basketbollit dhe/ose ndonjë pale tjetër të tretë.

**3.** Shikuesit dhe pjesëtarët e tjerë të publikut në dhe përreth sallës nuk do të përfshihen në sjellje josp sportive ndaj ndonjë pale të basketbollit dhe/ose ndonjë pale tjetër të tretë. Në veçanti, ndër të tjera, shikuesit:

**3.1.** Nuk do të nxisin dhunë ndaj palëve të basketbollit, përfshirë përkrahësit ose ndonjë palë tjetër të tretë;

**3.2.** Nuk do të hedhin gjësende, të cilat mund të shkaktojnë ose të mos shkaktojnë lëndime;

**3.3.** Nuk do të ndezin fishekzjarrë ose gjësende të tjera;

**3.4.** Nuk do të përfshihen në mënyrë tjetër në sjellje të rrezikshme dhe/ose kërcënuese, përfshirë edhe ndaj zyrtarëve të ndeshjes (p.sh. thirrje kërcënuese, përdorimi i dritave laserike, etj.) ose ndaj ndonjë pale tjetër të tretë;

**3.5.** Nuk do të hyjnë pa autorizim të duhur ose të hyjnë në parket para, gjatë ose pas një ndeshjeje zyrtare, ose

**3.6.** Nuk do të veprojnë në mënyrë agresive brenda dhe jashtë parketit ndaj palëve të basketbollit, përfshirë edhe ndaj përkrahësve.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## KREU V. LOJA E NDERSHME (FAIR PLAY)

### NENI 11 - 'RREGULLAT E ARTA'

1. 'Rregullat e Artat' të mëposhtme shërbejnë jo vetëm si filozofi për anëtarët e basketbollit, por gjithashtu ato përforcojnë ndjenjën e vëllazërisë dhe bashkëpunimit.

2. Këto nene të Lojës së Ndershme zbatohet për të gjitha lojërat dhe aktivitetet zyrtare dhe ndër të tjera përfshin edhe tërheqjen e shortit për garat e basketbollit, përveç nëse nuk parashihet ndryshe në rregulloret për gara specifike të miratuara nga FIBA ose nga një Zonë.

3. Palët e basketbollit do t'iu përmbahen këtyre **'Rregullave të arta'**:

**3.1. Luaj me nder:** Fitorja nuk ka vlerë nëse është arritur në mënyrë të padrejtë dhe të pandershme. Të bësh hile është lehtë, por nuk sjell kënaqësi. Loja e ndershme kërkon guxim dhe karakter. Gjithashtu, sjell më shumë kënaqësi. Duke luajtur me nder fiton respekt, kurse hileja sjell vetëm turp. Mos harroni: është vetëm lojë. Dhe loja nuk ka kurrfarë kuptimi nëse nuk luhet në mënyrë të ndershme.

**3.2. Luaj për të fituar, por pranoje humbjen me dinjitet:** Fitorja është qëllimi i çdo loje. Kurrë mos ia filloni lojës për të humbur. Nëse nuk luani për të fituar, atëherë po i mashtroni kundërshtarët, shikuesit dhe veten. Mos u dorëzoni kurrë, madje as kundër kundërshtarëve më të fortë, por as mos i nënçmoni kundërshtarët më të dobët, sepse është fyerje për çdo kundërshtar nëse nuk e jepni më të mirën. Luani për të fituar deri në fishkëllimën e fundit. Por, mbani në mend se askush nuk fiton gjithmonë. Nganjëherë fitoni, nganjëherë humbni. Mësoni të humbni me nder. Mos kërkoni arsyetim për humbjen. Arsyet e njëmendta gjithmonë do të dalin në pah. Uroni fituesit me dashamirësi. Mos i fajësoni gjyqtarët apo dikë tjetër. Vini vetes qëllim që herën e ardhshme të luani më mirë. Humbësit e mirë fitojnë më shumë respekt se sa fituesit e këqij.





**3.3. Respektoni kundërshtarët, bashkë-lojtarët, gjyqtarët, zyrtarët e lojës dhe shikuesit:** Loja e Ndershme (Fair-Play) nënkupton respekt. Respekti është pjesë e lojës sonë. Nuk mund të ketë lojë pa kundërshtarë. Gjyqtarët janë aty për të mbajtur disiplinën dhe për të siguruar se loja luhet në mënyrë të ndershme. Pranoni vendimet e tyre gjithmonë pa diskutim dhe ndihmoni ata që të gjithë pjesëmarrësit të kënaqen sa më shumë në lojë. Zyrtarët dhe shikuesit janë po ashtu pjesë e lojës dhe duhet t'i respektoni siç duhet.

**3.4. Përqafoni barazinë:** Të gjithë i kanë të drejtat e njëjta, përfshirë edhe të drejtën për tu respektuar. Trajtoni të gjithë pjesëtarët e familjes së basketbollit sipas parimit të barazisë. Bashkë-lojtarët janë kolegë. Ndërtoni një ekip ku të gjithë janë të barabartë.

**3.5. Promovoni interesat e basketbollit:** Vini interesat e basketbollit para interesave tuaja. Mendoni se si veprimet tuaja mund të ndikojnë në imazhin e lojës. Flisni për gjëra pozitive në lojë. Inkurajoni të tjerët për të shikuar lojën dhe luani basketboll në mënyrë të ndershme. Ndhmoni të tjerët të kënaqen me basketboll po aq sa ju. Bëhuni ambasador i këtij sporti. Shikuesit janë ata që krijojnë atmosferë në lojë. Ata duan të shohin lojë të ndershme, por edhe ata duhet të sillen siç duhet dhe me respekt.

**3.6. Nderoni ata që e mbrojnë reputacionin e mirë të basketbollit:** Emri i mirë i basketbollit ka mbijetuar sepse shumica dërrmuese e njerëzve që e duan këtë sport janë të ndershëm dhe të drejtë. Nganjëherë dikush bën diçka të jashtëzakonshme që meriton mirënjohjen tonë të veçantë. Ata duhet të nderohen dhe shembulli i tyre i mirë të promovohet. Kjo i inkurajon të tjerët të veprojnë njëjtë. Ndhmoni në promovimin e imazhit të basketbollit duke e bërë atë edhe më të njohur për veprat e mira.

**3.7. I thoni jo korrupsionit, drogës, racizmit, dhunës, bixhozit dhe rreziqeve të tjera që i kanosen sportit tonë:** Popullariteti i madh i basketbollit nganjëherë e bën atë të ndjeshëm ndaj interesave negative të jashtëm. Kini kujdes ndaj përpjekjeve për t'ju shtyrë për të mashtruar ose përdorur drogë. Droga nuk ka vend në basketboll, e as në ndonjë sport tjetër dhe shoqëri në përgjithësi. Trajtoni të gjithë lojtarët dhe të tjerët në mënyrë të barabartë, pavarësisht fesë, racës,

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:







gjinisë ose prejardhjes së tyre kombëtare. Bëhu i pamëshirshëm ndaj bast-vënies në ndeshjet në të cilat merrni pjesë. Kjo ndikon në aftësinë tuaj për performancë dhe krijon perceptimin e konfliktit të interesit. Tregoni se basketbolli nuk e do dhunën, madje as nga vetë tifozët tuaj. Basketbolli është sport dhe sporti është paqe.

### **3.8. Ndhmoni të tjerët t'ju rezistojnë presioneve korruptuese:**

Mund të keni dëgjuar se bashkë-lojtarët ose të tjerët që i njihni po tundohen për të bërë hile ose për t'u përfshirë në sjellje që konsiderohet e papranueshme. Ata kanë nevojë për ndihmën tuaj. Mos ngurroni t'ju qëndroni pranë. Jepuni forcë për të rezistuar. Përkujtojuani zotimin e tyre ndaj bashkë-lojtarëve dhe ndaj vetë lojës. Formoni një bllok solidariteti, si një mbrojtje të fortë në parket.

### **3.9. Denonconi ata që përpiqen të diskreditojnë sportin tonë:**

Mos t'ju vjen turp që të përballeni me këdo që jeni të sigurt se po përpiqet t'i nxisë edhe të tjerët të bëjnë hile ose të përfshihen në sjellje tjetër që konsiderohet e papranueshme. Është më mirë t'i ekspozoni dhe t'i largoni ata para se të mund të shkaktojnë dëm sepse është po aq e pandershme të mbyllësh sytë ndaj një veprimi të pandershëm. Mos thoni thjeshtë vetëm „Jo“. Denonconi ata persona, të cilëve iu ka humbur rruga dhe të cilët përpiqen të prishin sportin tonë, para se të bindin edhe dikë tjetër për të thënë „Po“.

### **3.10. Përdoreni basketbollin për të bërë botën më të mirë:**

Basketbolli ka fuqi të jashtëzakonshme, e cila mund të përdoret për ta bërë botën vend më të mirë ku mund të jetojnë të gjithë. Përdoreni këtë platformë të fuqishme për të promovuar paqe, barazi, shëndet dhe edukim për të gjithë. Bëjeni sportin e basketbollit më të mirë, përhapeni atë nëpër botë dhe do të krijoni një botë më të mirë.

## **KREU VI. KUJDESI**

### **NENI 12 - MIRËQENIA E LOJATRËVE**

**1.** Të gjithë kanë të drejtë të marrin pjesë në basketboll në një mjedis të sigurt dhe të këndshëm. FBK është e përkushtuar të mbrojë mirëqenien e

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





lojtarëve, duke përfshirë mos-diskriminimin dhe parandalimin e ngacmimit dhe abuzimit.

**2.** Palët e basketbollit i respektojnë dhe i promovojnë të drejtat e grupeve të ndjeshme.

## NENI 13 - DETYRIMET PËR KUJDES NDAJ TË TJERËVE

**1.** Palët e basketbollit duhet të familjarizohen dhe përmbahen detyrimeve për kujdes ndaj të tjerëve, që përfshijnë:

**1.1.** Të mundësojnë sigurinë e çdo grupi të ndjeshëm nën përkujdesjen e tyre;

**1.2.** Të veprojnë gjithmonë në interesin më të mirë të grupeve të ndjeshme;

**1.3.** Të mbajnë gjatë gjithë kohës kufij të përshtatshëm dhe profesional;

**1.4.** Të trajtojnë të gjithë individët, veçanërisht grupet e ndjeshme, në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, me respekt dhe dinjitet.

**1.5.** Të sigurojnë zbatimin e standardeve të njëjta profesionale pavarësisht prejardhjes etnike, ngjyrës, kombit, racës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, moshës ose aftësisë së veçantë;

**1.6.** T'i kuptojnë nevojat për zhvillimin e të miturve dhe kapacitetin e grupeve të ndjeshme;

**1.7.** Të promovojnë mjedis të sigurt dhe të këndshëm;

**1.8.** Të sigurohen që çdo shqetësim ose pretendim lidhur me mirëqenien e grupeve të ndjeshme trajtohet dhe regjistrohet në përputhje me këtë rregullore; dhe

**1.9.** Të fuqizojnë dhe edukojnë grupet e ndjeshme për të drejtat e tyre.

### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**2.** Ndalohen rreptësisht të gjitha format e ngacmimit, sharjes dhe abuzimit nga palët e basketbollit, qofshin ato fizike, profesionale apo seksuale, si dhe çdo lëndim fizik ose mendor që shkaktohet, mundësohet ose tolerohet jo-aksidentalisht. **Në veçanti, dhe ndër të tjera, palët e basketbollit nuk do të përfshihen në:**

**2.1. Nguca keqja (bullizëm).** Nguca keqja (ose ngacmimi kibernetik nëse bëhet në internet) ndër të tjera përshin sjelljen agresive të padëshiruar, të përsëritur dhe të qëllimshme, zakonisht ndodh në mesin e kolegëve/moshatarëve dhe mund të përfshijë një çekuilibër të vërtetë ose të perceptuar të pushtetit. Këtu mund të përfshihen edhe veprime të tilla si kërcënime, përhapjen e thashethemeve ose gënjeshtreve, sulmin fizik ose verbal dhe përjashtimin e qëllimshëm të dikujt;

**2.2. Detyrim me forcë (hazing).** Detyrimi me forcë (hazing) ndër të tjera mund të përfshijë një formë të organizuar, zakonisht të bazuar në ekip, të nguca keqes në sport, që përfshin "shprehjen e mirëseardhjes" me forma degraduese dhe të rrezikshme ndaj pjesëtarëve të ri nga ana e pjesëtarëve veteranë të ekipit;

**2.3. Homofobi.** Homofobia, ndër të tjera përfshinë antipatinë, neverinë, paragjykimin, averzionin ose urrejtjen në bazë të orientimit seksual, përkatësisht ndaj lezbikeve, gejëve, transgjitorëve, biseksualëve ose individëve të tjerë që identifikohen me gjini jo-binare;

**2.4. Shpërfillje.** Shpërfillja nënkupton dështimin e një trajneri ose personi, që e ka për detyrë të kujdeset ndaj një lojtari ose individi tjetër, për të ofruar nivelin minimal të kujdesit, që mund të shkaktojë dëm, lejon që të shkaktohet dëm ose krijon rrezik të menjëhershëm për lëndim;

**2.5. Neglizhencë.** Neglizhenca nënkupton një akt ose mosveprim lidhur me sigurinë e një lojtari ose personi tjetër, për të cilin pala e basketbollit e ka për detyrë të kujdeset, që ndër të tjera mund të përfshijë:

a) Privimi i lojtarit për të marrë ushqim ose pije;





- b) Privimi i lojtarit nga pushimi i mjaftueshëm dhe rigjenerimi;
- c) Mos-ofrimi i mjedisit të sigurt për ushtrime fizike; ose
- d) Zhvillimi i metodave trajnuese të papërshtatshme për moshën ose fizikun.

**2.6. Abuzim fizik.** Abuzimi fizik nënkupton dhunën e shkaktuar me qëllim ndaj një lojtari ose individit tjetër, që mund të përfshijë traumë ose lëndim fizik të shkaktuar me qëllim përmes grushtimit, rrahjes, shkelimit, kafshimit, djegies ose ndonjë forme tjetër që i shkakton lëndim sportistit. Kjo mund të përfshijë aktivitet fizik të pahijshëm, i cili mund të jetë i detyruar ose i lejuar (p.sh. ngarkesë gjatë trajnimit të papërshtatshëm për moshën dhe fizikun; gjatë lëndimeve ose kur ka dhimbje); konsumimi i detyruar i alkoolit; ose praktikat sistematike të dopingut.

**2.7. Abuzim psikologjik.** Abuzimi psikologjik nënkupton çdo trajtim që mund të ulë ndjenjën e identitetit, dinjitetit ose vetëvlerësimit dhe ndër të tjera, mund të përfshijë çdo vepër të padëshirueshme si mbylljen, izolimin, sulmin verbal, nënçmimin ose trajtimin si fëmijë;

**2.8. Abuzim seksual.** Abuzimi seksual nënkupton sjellje të natyrës seksuale, qoftë pa kontakt, përmes kontaktit ose penetrimit, ku pëlqimi merret me forcë/në mënyrë të manipuluar, nuk është dhënë ose nuk mund të jepet; dhe

**2.9. Ngacmim seksual.** Ngacmimi seksual nënkupton sjellje të padëshiruar të natyrës seksuale, qoftë verbale, jo-verbale ose fizike.

## KREU VII. KONFIDENCIALITETI

### NENI 14

**1.** Asnjë palë e basketbollit nuk duhet të zbulojë në asnjë rrethanë informata të besueshme të pranuar nga FBK ose gjatë kryerjes së detyrave zyrtare ose jozyrtare në emër të FBK-së, duke përfshirë, ndër të tjera, dokumentacionin e punës për çdo takim zyrtar të FBK-së (p.sh. Bordi,

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Komiteti Ekzekutiv, Komisionet, etj.), përmbajtjen e diskutimeve nga çfarëdo takimi zyrtar i FBK-së ose me ndonjë Administrator të FIBA-s ose çfarëdo informate tjetër të komunikuar të besueshme.

**2.** Të gjitha palët ndalohen rreptësishtë që - pa miratimin paraprak me shkrim të FBK-së - të bëjnë incizime me çfarëdo aparati, që ndër të tjera përfshijnë video, foto ose audio-incizimet e çfarëdo takimi (zyrtar ose tjetër), përfshirë edhe të takimeve të Bordit, Komisioneve ose çfarëdo shkëmbimi tjetër që përfshin ndonjë palë të basketbollit.

## KREU VIII. ADMINISTRIMI I MIRË

### NENI 15

**1.** Palët e basketbollit administrojnë organizatat e basketbollit në mënyrë transparente dhe të drejtë, pa paragjykime dhe korrupsion, dhe përmes zgjedhjeve dhe proceseve të hapura dhe demokratike, që ndër të tjera, përfshijnë:

**1.1.** Menaxhimin e përditshëm sipas parimeve demokratike dhe të llogaridhënies, duke përfshirë menaxherë profesionalë, të cilët i japin përgjegjësi dhe i raportojnë Bordit/Komitetit Ekzekutiv/Komitetit të Menaxhimit të tyre, kurse ato organe i japin përgjegjësi dhe iu japin llogari pjesëtarëve/hisedarëve të tyre;

**1.2.** Të mundësojnë transparencë dhe ndershmëri në të gjitha punët e administrimit dhe funksionimit;

**1.3.** Të sigurojnë që vendimet janë të bazuara, për aq sa është e mundur, në kriteret objektive e jo subjektive;

**1.4.** Të sigurojnë me përgjegjësi të madhe që nuk përfshihen në mashtrim, praktikë jo-etike dhe sjellje tjetër që mund të interpretohet si e pandershme ose e dëmshme për basketbollin;

**1.5.** Të veprojnë në përputhje me përgjegjësinë e bartësit të detyrës, duke e respektuar frymën dhe tërësinë e ligjit, duke i kuptuar detyrat ligjore dhe morale të rolit të tyre;

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**1.6.** Nuk bëjnë asgjë që në çfarëdo mënyre njollos basketbollin ose dëmton imazhin e tij publik të cilitdo nivel;

**1.7.** Menaxhojnë raportet dhe transaksionet me sponsorët, partnerët komercialë, shitësit, furnitorët dhe konsulentët në mënyrë etike në përputhje me këtë Kod të Etikës;

**1.8.** Lidhin kontrata ose marrëveshje tjera me organizatat, të cilat merren me biznes që ka të bëjë në spekulim të rezultateve ose përfundimet tjera të ngjarjeve sportive deri në atë nivel që një aktivitet i tillë nuk bie ndesh me këtë Kod të Etikës;

**1.9.** Sigurojnë zbulim të plotë, të drejtë, të saktë dhe në kohë të informatave në raportet për FIBA-n ose për çdo autoritet tjetër më të lartë brenda basketbollit, siç mund të kërkohen dhe gjithashtu për autoritetet zyrtare përkatëse në Republikën e Kosovës;

**1.10.** Sigurojnë mbrojtjen, respektimin dhe ruajtjen e të drejtave personale të individëve;

**1.11.** Sigurojnë privatësinë e individëve (përveç informacionit thelbësor për funksionimin e organizatës);

**1.12.** Promovojnë shëndet dhe mirëqenie fizike dhe mendore të lojtarëve;

**1.13.** Sigurojnë proces të mirëfilltë në çështjet disiplinore; dhe

**1.14.** Përfaqësojnë basketbollin me ndershmëri, denjësisht, me respekt dhe integritet.

**2.** Kur FIBA u jep mbështetje financiare palëve të basketbollit, të dhënat financiare dhe llogaridhënia duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga FIBA dhe në përputhje me parimet përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## KREU IX. KONFLIKTI I INTERESIT

### NENI 16 - QËLLIMI I DISPOZITAVE PËR KONFLIKT INTERESI

1. FBK është e përkushtuar të ruajë standardet më të larta të qeverisjes së mirë dhe i kryen punët e saj në mënyrë të hapur dhe transparente.
2. Qëllimi i këtyre dispozitave për konfliktin e interesit është të mbrojë FBK-në, FIBA-n dhe individët në fjalë nga çfarëdo perceptimi të sjelljes së pahijshme. Palët e basketbollit përpiqen të zvogëlojnë dhe eliminojnë rastet e konfliktit të interesit duke qenë të vetëdijshëm, të kujdesshëm dhe të raportojnë menjëherë për ndonjë konflikt të mundshëm.

### NENI 17 - OBLIGIMI NDAJ FBK-SË

1. Individët që veprojnë në emër të FBK-së para së gjithash kanë obligim ndaj FBK-së. Çdo interes personal që e kanë në veprimtarinë e FBK-së duhet të vijë pas kësaj detyre.
2. Individët që veprojnë në emër të FBK-së duhet të sillen gjatë gjithë kohës me integritet, paanshmëri dhe ndershmëri dhe duhet të mbajnë standarde të larta të korrektësisë dhe profesionalizmit. Ata duhet t'ju shmangen situatave që mund të ngrenë dyshime për pandershmëri nga ana e FBK-s apo e tyre.
3. Konform Statutit të FBK-së, palët e basketbollit kanë obligim të shmangin Konfliktin e interesit.
4. Ndërmjet interesit personal të një zyrtari të FBK-së dhe interesave të FBK-së, zyrtarët e FBK-së duhet të zgjidhin çdo Konflikt interesi monetar ose jo-monetar në favor të FBK-së.
5. Zyrtarët e FBK-së nuk do:
  - 5.1. Përfshihen në ndonjë biznes ose transaksion apo të kenë interes financiar ose interes tjetër personal që nuk është në pajtueshmëri me detyrat e tyre zyrtare me FBK, përveç nëse ata i kanë deklaruar

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





paraprakisht dhe kanë marrë miratimin nga FBK për këto biznese, transaksione ose interesa tjerë.

**5.2.** Të vënë veten me vetëdije në pozitë të tillë që i detyrohen ndonjë personi tjetër, i cili pastaj mund të përfitojë nga statusi i veçantë apo që mund të kërkojë trajtim preferencial;

**5.3.** Gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare, iu japin trajtim preferencial anëtarëve të familjes, miqve të ngushtë, kolegëve ose organizatave, në të cilat anëtarët e familjes, miqtë e ngushtë ose kolegët kanë interes financiar ose interes tjetër;

**5.4.** Të nxjerrin përfitime personale nga informatat që i kanë kuptuar gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare me FBK, nëse informacioni i tillë është i besueshëm ose në të cilin publiku përgjithësisht nuk ka qasje.

**5.5.** Të përfshihen në punë, veprimtari apo ndërmarrje afariste ose profesionale të jashtme që bie ndesh ose që mund të perceptohet se është në konflikt me detyrat e tyre zyrtare me FBK apo që kanë përparësi ose duket që kanë përparësi për shkak të lidhjes së tyre me FBK;

**5.6.** Të përdorin pronën, pajisjet, furnizimet ose shërbimet e FBK-së për aktivitetet që nuk lidhen me performancën e detyrave të tyre zyrtare pa miratimin e FBK-së.

**5.7.** Duke qenë zyrtar i FBK-së, të vendosen në pozitë të tillë ku mund të ndikojnë në vendimet ose kontratat nga të cilat mund të nxjerrin përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta; ose

**5.8.** Të pranojnë ndonjë dhuratë ose favor që mund të interpretohet që po jepet si shpërblim në pritje të apo në mirënjohje të ndonjë trajtimi të posaçëm për shkak të pozitës si zyrtar i FBK-së.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:







## NENI 18 - DEKLARIMI I ÇDO KONFLIKT INTERESI

1. Në fillim të emërimit, të gjithë zyrtarët e FBK-së do të deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të kenë (sipas nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik).
2. Përveç kësaj, zyrtarët e FBK-së do t'i deklarojnë me shkrim, para Bordit të FBK-së, çdo Konflikt të Interesit menjëherë pasi të kenë kuptuar se mund të ekzistojë ndonjë i tillë. Zyrtarët e FBK-së gjithashtu duhet t'i deklarojnë të gjitha lidhjet me ndonjë nga organizatat e përfshira në basketboll. Këto lidhje përfshijnë cilindo nga rolet në vijim: sportist, trajner, menaxher, zyrtar, punonjës, vullnetar ose drejtor.
3. Në fillim të çdo mbledhjeje të Bordit të FBK-së, anëtarët mund të pyesin nëse dikush dëshiron të deklarojë ndonjë konflikt të interesit të padeklaruar më parë.

## KREU X. BAST-VËNIA DHE MANIPULIMI I GARAVE

### NENI 19 - BAST-VËNIA APO MANIPULIMI

1. Në bazë të parimeve të FIBA-s dhe Ligjit Nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit, Palët e basketbollit nuk do të përfshihen në asnjë nga sjelljet e mëposhtme:

**1.1. Kurdisje/Bast-vënie:** Përfshirja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e një pale të basketbollit në çfarëdo forme të basteve që lidhen me një garë të basketbollit ose me garat e tjera ndërkombëtare të basketbollit, pavarësisht a janë të njohura apo jo, ku një ose më shumë pjesëmarrës janë në të njëjtën kohë mbajtës të një licence të lëshuar nga FIBA ose nga një Federatë Kombëtare anëtare e FIBA-s (një „Garë e mbrojtur“) duke përfshirë bastet (dhe aktivitetet e lidhura me bastet) me ose përmes një personi tjetër për rezultatin, progresin, përfundimin, sjelljen ose çdo aspekt tjetër të një gare të tillë të mbrojtur;

### 1.2. Manipulimi i rezultateve:

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**a)** Kurdisja ose fiksimi në çfarëdo mënyrë ose duke ndikuar në mënyrë të pahijshme apo duke qenë pjesë e kurdisjes ose fiksimit në ndonjë mënyrë ose duke ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në rezultatin, progresin, përfundimin, sjelljen ose çdo aspekt tjetër të një gare të mbrojtur;

**b)** Të sigurojnë ose të përpiqen për të siguruar që do të ndodhë një incident/vepër në një garë të mbrojtur, ndodhi që sipas dijenisë së palës së basketbollit është objekt i një basti dhe për të cilin pala e basketbollit ose një person tjetër pret të përfitojë ose tashmë ka përfituar; ose

**c)** Dështimi për të bërë më të mirën e mundur në një garë të mbrojtur në këmbim të përfitimit (ose pritshmëria legjitime e përfitimit, pavarësisht nëse një përfitim në fakt jepet ose merret).

### 1.3. Sjellja korruptive:

**a)** Pranimi, ofrimi, pajtimi për të marrë ose ofruar ryshfet ose përfitim tjetër (ose pritshmëria legjitime e përfitimit, pavarësisht nëse një përfitim në fakt jepet ose merret) për të kurdisur ose fiksuar në ndonjë mënyrë ose duke ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në rezultatin, progresin, përfundimin, sjelljen ose çdo aspekt tjetër të një gare të mbrojtur; ose

**b)** Sigurimi, ofrimi, dhënia, kërkimi ose pranimi i një dhurate ose përfitimi (ose pritshmëria legjitime e përfitimit, pavarësisht nëse një përfitim në fakt jepet ose merret) në rrethana kur një palë e basketbollit në mënyrë të arsyeshme mund të kishte pritur, të cilat mund të çnderojnë atë ose sportin.

### 1.4. Keqpërdorimi i informatave të brendshme:

**a)** Përdorimi i informatave të brendshme për qëllim të bast-vënies ose në lidhje me bastet; ose

**b)** Dhënia e informacionit të brendshëm personave të tjerë - me apo pa përfitim - ku pala e basketbollit në mënyrë të arsyeshme pritet të dijë që zbulimi i informacionit në rrethana të tilla mund të përdoret për bast-vënie.

#### Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





**2.** Dispozitat në vijim nuk janë relevante për përkufizimin e ndonjë shkeljeje të Bast-vënies ose Manipulimit të Garës:

**2.1.** Pa marrë parasysh a ka marrë pjesë apo jo pala e basketbollit në garën specifike të basketbollit, si dhe pa marrë parasysh a është ndihmuar ajo nga një palë tjetër e basketbollit;

**2.2.** Natyra ose përfundimi i çdo Basti në fjalë;

**2.3.** Përfundimi i garës për të cilën është vënë basti;

**2.4.** Pa marrë parasysh nëse përpjekjet ose performanca (nëse ka pasur) e palës së basketbollit në garën në fjalë të basketbollit është ndikuar (ose mund të pritët të ndikohet) nga veprimet ose mosveprimet në fjalë; ose

**2.5.** Pa marrë parasysh nëse rezultatet në garën në fjalë të basketbollit ishin ndikuar (ose pritëshin të ndikoheshin) nga veprimet ose mosveprimet në fjalë.

## KREU XI. KOMISIONI I ETIKËS

### NENI 20 - VEPRIMTARIA, ANËTARËT DHE PROCEDURAT

**1.** Komisioni i Etikës ka për detyrë të shqyrtojë shkeljet e mundshme të Kodit të Etikës dhe më pas të raportojë për hetimet dhe diskutimet e kryera.

**2.** Komisioni i Etikës përbëhet nga 6 anëtarë, përkatësisht nga:

**2.1.** SPOC (Personi Kontaktues për Integritet)

**2.2.** Sekretari i Përgjithshëm

**2.3.** Komesari i Garave

**2.4.** Kryetari i Komisionit të Arbitrazhit

**2.5.** Kryetari i Komisionit Disiplinor

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## 2.6. Një anëtar i Bordit (që ka njohuri për baza ligjore në Kosovë).

3. Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së do të thërrasë mbledhjen e parë të këtij grupi, por SPOC-u do të kryesojë mbledhjen dhe të gjitha mbledhjet e ardhshme të këtij Komisioni.

4. Komisioni i Etikës nuk ka fuqi të drejtpërdrejtë të sanksionimit. Sekretari i Përgjithshëm dhe/ose Bordi mund të merren me një konstatim prima facie të pafavorshëm nga Komisioni i Etikës dhe mund të vendosin t'ia referojnë çështjen Komisionit Disiplinor të FBK-së për seancë formale sipas proceseve disiplinore.

## KREU XII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### NENI 21 - JURIDIKSIONI

1. Ky Kod i Etikës i miratuar nga Bordi i FBK-së zbatohet brenda juridiksionit të FBK-së, por nuk anashkalon Kodin e Etikës dhe Integritetit të FIBA-s dhe ligjet përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës.

2. Shkeljet e pretenduara të Kodit të Etikës brenda juridiksionit të FBK-së do të trajtohen nga Komisionet përkatëse të FBK-së, përveç rastit kur pretendimi për shkelje përfshin vetë Federatën, në të cilin rast çështja do të jetë për shqyrtim nga FIBA.

3. Të gjitha palët e basketbollit, duke përfshirë pjesëmarrësit në garat e FBK-së, anëtarët e FBK-së, duhet të jenë në dijeni dhe ti përmbahen këtij Kodi.

4. FBK duhet të njoftojë FIBA-n për çdo sanksion disiplinor të vendosur nga Federata për ndonjë incident që ka ndodhur në kundërshtim me këtë Kod ose me rregulloret e ngjashme të miratuara nga FBK dhe FIBA.

### NENI 22 - PROGRAMET EDUKATIVE

1. FBK, me udhëzim nga FIBA, pajtohet të hartoj dhe zbatoj programe edukative për palët e interesuara në basketboll me qëllim të rritjes së





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës

+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Faza 2  
Str: Radovan Zogoviq  
10 000 Prishtina

vetëdijesimit në mesin e tyre për kërcënimet e mundshme ndaj integritet dhe familjarizimin me rregullat dhe rregulloret, si dhe me mekanizmat e raportimit.

## NENI 23 - INTERPRETIMI I KODIT ETIK

1. Interpretimin i këtij Kodi e bënë Bordi i FBK-së, në përputhshmëri të plotë me Rregulloret e Brendshme të FBK-së.

Në emër të Bordit Ekzekutiv të FBK-së,

Kryetari

Arben **FETAHU**



Federata e Basketbollit e Kosovës

Prishtinë, 03.10.2022

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

